



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

Data: 16.05.2023

Nr: 78

Ora: 18:00

**URDHËR**

**PËR**

**VERIFIKIMIN E SHKAQEVE TË MOSFUNKSIONIMIT TË PAISJES ELEKTRONIKE TË IDENTIFIKIMIT TË ZGJEDHËSVE (PEI) NË DISA QENDRA VOTIMI NË ZGJEDHJET E DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të neneve 14 dhe 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

**URDHËROJMË:**

1. Ngritjen e një grupi pune të përbërë me përfaqësues të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), si dhe me ekspertë të jashtëm me njohuri në fushën e teknologjisë së informacionit.
2. Grupi i punës ka këto detyra:
  - a) Të evidentojë qendrat e votimit, nga të cilat në ditën e zgjedhjeve në 14 Maj 2023 nuk pati transmetim të të dhënave mbi procesin e identifikimit elektronik nëpërmjet PEI, në KQZ.
  - b) Të evidentojë cilat PEI u dërguan në qendrat e votimit nga të cilat nuk pati transmetim të të dhënave nga qendrat e votimit, sikurse përcaktohet në gërmën “a” të kësaj pike.
  - c) Të verifikojë modulet fizike (hardware) dhe ato programore (software) të shtuar për çdo PEI të përcaktuar sipas gërmës “b” të kësaj pike. Pas përfundimit të këtij verifikimi grupi i punës të përgatisë një raport teknik mbi gjetjet, për çdo PEI në veçanti.
3. Ngarkohet Sekretari i KQZ me caktimin e anëtarëve e grupit të punës nga administrata e KQZ.
4. T’i kërkohet kompanisë furnizuese të PEI të caktojë një ekspert teknik për të qenë pjesë e grupit të punës të ngritur sipas këtij urdhri.

Data: 16.05.2023 Nr: 78  
Ora: 16:00



Për verifikimin e shkaqeve të mosfunksionimit të PEI në disa qendra votimi në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023.

5. Raporti i grupit të punës i dorëzohet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, jo më vonë se 30 ditë nga data e krijimit të grupit të punës.
6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Logjistikës dhe e Digjitalizimit për zbatimin e këtij urdhri.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Lealba PELINKU**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**